



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:095323
Datë: 09.01.2025
Numri i dokumentit: 06690149

AC.nr.8254/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË -në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar i kolegjit, Naime Ahmeti dhe Halide Reka, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, B., “B.K”, nr..., të cilën e përfaqëson D.R nga Gjilani, kundër të paditurit H.J.H nga Gjilani, Rr. “M.K”, nr..., me objekt kontesti kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 688.90 euro, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.376/2019, i datës 17.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.376/19 të datës 17.10.2022.

PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.376/2019 i datës 17.10.2022 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar me ankesë, C.nr.376/2019, i datës 17.10.2022, ka vendosur si në vijim: I. REFUZHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurit H.H nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që t’ia paguaj paditësit dëmin e shkaktuar material në shumë prej 688.90 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që ankesa e tij të pranohet si e bazuar, aktgjykimi të ndryshohet ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar dhe të obligoj të paditurin që paditëses t ia kompensoj dëmin e shkaktuar

material në shumë prej 688.90 euro me kamatë ligjore 8% vjetore në bazë të LMD-së dhe kërkojnë shpenzimet e procedurës kontestimore për Padi dhe Aktgjykim.

I padituri nuk ka dorëzuar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me dispozitën e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rrjedhë se paditësi Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS) ka dorëzuar padi për kompensimin e dëmit material kundër të paditurit H.H.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore, administrimit të provave me aktgjykimin e atakuar me ankesë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim në mes të tjerave ka theksuar: Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Nga Aktgjykimi Penal P.nr.251/14 i datës 10.01.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se i padituri është shpallë fajtor për veprën penale lidhja e paautorizuar në shërime, nga e cila vepër është dëmtuar paditësi në vlerën prej 294.90 euro.

Nga Transaksioni i konsumatorit me numër DGL-..., i datës 13.04.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se më datë 28.01.2014, për rikthim të humbjeve, paditësit i figuron borxhi në vlerë prej 688.90 euro. Gjykata, pavarësisht se nga gjendja faktike e vërtetuar si më lartë, gjeti se i padituri ka vepruar në kundërshtim me dispozitat nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), edhe atë nenit 8 që përcakton se “Secili person ka për detyrë të përmbahet nga veprimi që mund t’i shkaktoj dëm tjetrit”; nenit 136, paragrafi 1 “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”; nenit 137 “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”, nenit 140 “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”; si dhe nenit 169, paragrafi 1 “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”; mirëpo për shkak se në procedurë civile duke u bazuar në nenin 7, 319 dhe 322 të LPK-së, është detyrë e palëve që të paraqesin faktet mbi të cilat mbështetin kërkesat e tyre dhe të propozojnë prova me të cilat konstatojnë faktet e tilla, ashtu që secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, pasi pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, ndërsa në qoftëse gjykata në bazë të provave të marra nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës; gjykata ka vendosë që të refuzojë kërkesëpadinë e të njëjtit, pasi paditësi nuk ka provuar lartësinë e kërkesëpadisë, kurse vetëm fakti se i është shkaktuar dëm, pa ia vërtetuar lartësinë e dëmit të shkaktuar, mund vetëm të shpie te vërtetimi i një kërkesë, por jo edhe te detyrimi i asaj. Duke qenë se ka qenë detyrim i paditësit që të provojë faktin që është qenësor për realizimin e kërkesës së tij (lartësinë e dëmit të shkaktuar), gjykata gjeti se i njëjti ka dështuar të provojë një fakt të tillë, andaj edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Madje, gjykata ka gjetur se paditësi as nuk ka bërë përpjekje për të vërtetuar sa është lartësia e

dëmit të shkaktuar, kjo nisur nga fakti se nuk ka deponuar mjetet e kërkuara për përpilim të ekspertizës, ndërsa nga lartësia e dëmit e konstatuar në aktgjykimin penal dhe lartësia e dëmit e kërkuar me kërkesëpadi ka diferencë të dukshme, kurse nga transaksioni i konsumatorit, gjykata nuk ka mund të vërtetojë se rikthimi i humbjeve në vlerën prej 688.90 euro, përfshin lartësinë për dëmin e shkaktuar mbi bazën e të cilës kërkon shpërblimin e dëmit me këtë kërkesëpadi paditësi. Në fakt, gjykata vlerëson se meqë në transaksion, lartësia e këtij dëmi nuk përputhet me lartësinë e dëmit në aktgjykimin penal, nuk mund të konstatohet saktë se a bëhet fjalë për dëmin e njëjtë të shkaktuar nga ndryshimi i njehsorit nga ana e të paditurit, apo bëhet fjalë për tjetër dëm dhe se edhe ky dëm ka qenë kontestues nga i paditur. Gjukata, e ka parasysh faktin se në procedurë civile nuk është e lidhur domosdoshmërisht për procedurën penale, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare e në kuptim të nenit 356 të LPK, i plotësuar me nenin 21 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPK, vendosi që në këtë çështje është i nevojshëm të provuarit me ekspertizën e elektroteknikës, e cila ekspertizë do të mund të qartësonte pretendimet e paditësit, si dhe faktet e pakonstatuara të gjykatës të theksuara si më lartë, mirëpo një gjë e tillë ishte e pamundur pasi që pala paditëse nuk i ka deponuar mjetet për shpërblimin e punës së ekspertit. Meqë, gjykata vlerësoi se përpilimi i ekspertizës i përgjigjet vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike – përcaktimit të lartësisë së dëmit, si dhe interesit të paditësit për të vërtetuar pretendimet e tij, ka detyruar paditësin në deponim të mjeteve, pavarësisht se i padituri e ka kontestuar lartësinë dhe ka kërkuar që lartësia e kërkesës së paditësit duhet të provohet me ekspertizën përkatëse, pasi edhe nëse është në interes të të njëjtit të vërtetohet se lartësia e dëmit është tjetër nga ajo e kërkuar me padi, i njëjti është palë në procedurë sipas inicimit të kërkesëpadisë nga paditësi, pra sipas interesit të paditësit për këtë çështje kontestimore. Në mungesë të të provuarit përmes ekspertizës së elektroteknikës gjykata e ka pas të pamundur vendosjen në këtë çështje të lartësisë së kërkesës çoftë lidhur me dëmi që është konstatuar me aktgjykimin penal apo shuma e dëmit të pretenduar me transaksionet e konsumatorit. Sa i përket pretendimit të të paditurit se kërkesa e paditësit është e parashkruar, gjykata të njëjtën e vlerësoi të pabazuar, pasi me kërkesëpadi, paditësi nuk është duke kërkuar borxhin sipas kërkesës për energji elektrike, siç e përcakton neni 360 i LMD-së, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 se “kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”; por është duke kërkuar shpërblimin e dëmit, ndërsa parashkrimi për kërkesën e shpërblimit të dëmit është i përcaktuar në nenin 357 se “Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin”; andaj nuk gjen zbatim në rastin konkret neni 360 i këtij ligji, por neni 357, nga del se kërkesa nuk është e parashkruar, pasi aktgjykimi penal është marrë në vitin 2018, ndërsa padia është ushtruar në vitin 2019. Për shpenzimet e procedurës gjykata, ka vendosur në bazë të nenit 452, paragrafi 1 dhe 463, paragrafi 1 të LPK-së, pasi që pavarësisht se i padituri e ka fituar kontestin, i njëjti nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës. Nga të theksuarat si më lartë dhe bazuar në nenin 143 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjukata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes, përfundimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK.

Aktgjykimi ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të ekzaminohen, dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me arsyetimin dhe se i njëjti nuk përmban elementet e parapara sipas dispozitave të nenit 160 të LPK-s. Gjithashtu aktgjykimi është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183.2 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nuk pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se gjykata, e ka parasysh faktin se në procedurë civile nuk është e lidhur domosdoshmërisht për procedurën penale, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare e në kuptim të nenit 356 të LPK, i plotësuar me nenin 21 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e LPK, vendosi që në këtë çështja është i nevojshëm të provuarit me ekspertizën e elektroteknikës, e cila ekspertizë do të mund të qartësonte pretendimet e paditësit, si dhe faktet e pakonstatuara të gjykatës të theksuara si më lartë, mirëpo një gjë e tillë ishte e pamundur pasi që pala paditëse nuk i ka deponuar mjetet për shpërblimin, sepse sipas dispozitave të nenit 14 të LPK-së parashihet se në procedurën kontestimore gjykata në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.

Në bazë të këtyre dispozitave ligjore gjykata e shkallës së parë ka qenë e obliguar që me rastin e vendosjes të merr parasysh edhe aktgjykimin penal me të cilin tani i padituri është shpallur fajtor, sipas të cilit edhe mund të vërtetohet baza e kërkesëpadisë.

Udhëzohet gjykata e shkallës së parë që në riprocedurë ti evitoj të metat e lartcekura, ashtu që me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoj seancën e shqyrtimit për çka ti ftoj palët me anë të ftesave, në seancë, ti administrojë provat e propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të nxjerrë provat tjera eventuale që mund ti dorëzojnë palët ndërgjyqëse. Sa i përket përcaktimit të lartësisë së dëmit të kërkuar nga paditësi, gjykata e shkallës së parë të merr parasysh aktgjykimin penal, e nëse palët propozojnë nxjerrjen e provës me ekspert nga lëmia përkatëse, të njëjtët të detyrohen të deponojnë mjetet për ekspertizë e në të kundërtën të konstatohet se propozimi do të konsiderohet i tërhequr.

Pas vërtetimit të gjendjes faktike në mënyrë të plotë gjykata pastaj mund të bie vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Aktgjykimi duhet të përpilohet konform dispozitave të nenit 160 të LPK-së, ashtu që dispozitivi duhet të përmban vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Arsyetimi i aktgjykimit duhet të përmban, kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po qe se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

Gjykata posaçërisht duhet të tregojë se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohej edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor.

Gjykata e Apelit shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura më lartë Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitat e nenit 194 dhe 195 par. 1 pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2019:095323
Datë: 09.01.2025
Numri i dokumentit: 06690149

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË
AC.nr.8254/22 me datë 08.01.2025.

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v